

**VENDIM**  
**Nr. 804, datë 12.12.2022**

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 587, DATË 22.7.2020, TË KËSHILLIT  
TË MINISTRAVE, “PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR  
FINANCIMIN E RINDËRTIMIT TË NJËSIVE TË BANIMIT NË NDËRTESA  
(PALLAT), TË DËMTUARA, NË ZONAT E SHPALLURA PËR ZHVILLIM TË  
DETYRUAR”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nënndarjes “i”, të shkronjës “b”, të nenit 13, dhe të nenit 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 115/2021, “Për buxhetin e vitit 2022”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Në vendimin nr. 587, datë 22.7.2020, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhet ndryshimi, si më poshtë vijon:

“Në pikat 4 dhe 4.1, shifra dhe fjalët “... 3 671 841 924 (tre miliardë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e një milionë e tetëqind e dyzet e një mijë e nëntëqind e njëzet e katër) lekë pa TVSH ...” zëvendësohen me “... 6 241 428 906 (gjashtë miliardë e dyqind e dyzet e një milionë e katërqind e njëzet e tetë mijë e nëntëqind e gjashtë) lekë pa TVSH ...”.

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Fondi Shqiptar i Zhvillimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR**  
**Belinda Balluku**